



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 87

Tiranë – E hënë, 24 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10141, datë 14.4.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5107
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 223, datë 11.4.2017	Për ngritjen, përbërjen, kompetencat dhe procedurat e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, për sanksionet mbi moszbatimin e masave shtesë të sigurisë publike..... 5107
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 224, datë 11.4.2017	Për rregullat për kryerjen e inspektimeve nga Policia e Shtetit, për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë publike..... 5108
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11, datë 10.4.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 52, datë 3.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar..... 5109
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 18.4.2017	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm..... 5110
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 31.3.2017	Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror..... 5115
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 31.3.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 5115
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 31.3.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 5116
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 31.3.2017	Mbi fillimin e procedurës së licencimit të shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 5117
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 31.3.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 5118

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 6.4.2017	Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017.....	5118
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 6.4.2017	Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Universal për kategorinë objekte kulti/bashkësi fetare.....	5120
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2273, datë 19.4.2017	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (loti 3)” për pasuritë e llojit “pyll”....	5121

**DEKRET**

Nr. 10141, datë 14.4.2017

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.08.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Marilena Antonio Pizzuto

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

UDHËZIM

Nr. 223, datë 11.4.2017

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN,
KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT E
FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË
SHQYRTIMIT TË ANKESAVE, PËR
SANKSIONET MBI MOSZBATIMIN E
MASAVE SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7 të nenit 16 të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”,

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, i cili përbëhet nga:

- | | |
|---|---------|
| a) Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit | kryetar |
| b) Drejtori i Drejtorisë Juridike | anëtar |
| c) Shefi i Sektorit për Krimet e Pronës | anëtar |
| d) Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet | anëtar |
| e) Specialisti në Sektorin ndaj të Tretëve | anëtar. |

2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka në kompetencë shqyrtimin e ankimeve të paraqitura nga subjektet publike dhe private, për:

a) gjobat që vendosen nga Policia e Shtetit, ndaj këtyre subjekteve, për moszbatimin e masave shtesë të sigurisë, sipas llojit të masës, në varësi të aktivitetit që kryejnë dhe vlerësimit të rrezikut;

b) heqjen e “Vërtetimit të sigurisë”;

sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 4, të nenit 16 të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe të udhëzimit nr.134, datë 10.3.2017 të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit dhe vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”.

3. Ankimet e subjekteve publike dhe private administrohen nga specialisti në sektorin ndaj të tretëve, i cili relatton në mbledhjen e komisionit.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mbledhet me kërkesën e kryetarit.

5. Subjekti që paraqet ankim, ka të drejtë të përfaqësohet dhe të depozitojë ankimin dhe dokumentacionin e nevojshëm, para Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor, të autorizuar prej tij.

6. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga depozitimi i tij.

7. Subjekti njoftohet për datën e shqyrtimit të ankimit, sipas formave të njoftimit të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit dhe dëgjimit të subjektit ankues, Komisioni merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

8. Në rast se ndonjë nga anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka pengesë ligjore për ushtrimin e detyrës, sipas rasteve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, ai zëvendësohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

9. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

10. Ngarkohet Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Fatmir Xhafaj

**UDHËZIM**

Nr. 224, datë 11.4.2017

**PËR RREGULLAT PËR KRYERJEN E
INSPEKTIMEVE NGA POLICIA E
SHTETIT, PËR MONITORIMIN E
PËRMBUSHJES SË MASAVE SHITESË TË
SIGURISË PUBLIKE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 15 të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”,

UDHËZOJ:

1. Policia e Shtetit, nëpërmjet strukturave të saj, kryen inspektime në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për monitorimin e përmbushjes së masave shtesë të sigurisë, nga subjektet publike dhe private, në varësi të llojit dhe nivelit të masës së sigurisë, të përcaktuar nga komisioni i vlerësimit të masave të sigurisë.

2. Për kryerjen e inspektimit, hartohet plani i inspektimit, i cili miratohet nga drejtuesi i strukturës vendore të policisë, në të cilin përcaktohen:

- a) grupi i inspektimit i policisë së shtetit;
- b) territori, subjektet dhe/ose objektet që do të inspektohen;
- c) kohëzgjatja e kryerjes së inspektimit;
- d) masat shtesë që janë përcaktuar për çdo subjekt nga komisioni përkatës;
- e) mënyra e funksionimit të masave shtesë të sigurisë, sipas llojit të masës së parashikuar për subjektin që inspektohet.

3. Pas miratimit të planit të inspektimit, përgjegjësi i grupit të inspektimit të strukturës vendore të policisë njofton subjektin që do të inspektohet. Nëse do të inspektohet një ndërtesë banimi, në këtë rast njoftohet, struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe administratori apo sipas rastit, shoqëritë e administrimit të ndërtesave të banimit apo pronarët e objekteve.

4. Gjatë inspektimit në një subjekt, grupi i inspektimit ka të drejtë të verifikojë funksionimin e masave shtesë të sigurisë, sipas llojit të masës që detyrohet të zbatohet, konkretisht:

- a) funksionimin e sistemit të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike deri në 2 muaj;

- b) funksionimin e pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë për identifikim, si dedektorë, ura kontrolli, reader, GPS etj.;

- c) lidhjen e sinjalit të alarmit të bankave dhe objekte të rëndësishme shtetërore, në nivel qendror dhe vendor me sallat e komandimit të policisë së shtetit;

- d) kontraktimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike dhe respektimin e standardeve të kërkuara;

- e) funksionimin e kombinuar të disa masave shtesë të sigurisë publike.

5. Për kryerjen e inspektimit, grupi i inspektimit do të hyjë në objektet që do të inspektohen, ose në ambientet ku mbahen pajisjet regjistruese apo të identifikimit dhe do të mbikqyrë nëse pajisjet janë funksionale, në prani të subjektit që kontrollohet apo personit përgjegjës.

6. Grupi i inspektimit përbëhet nga jo më pak se tre punonjës policie. Gjatë inspektimit, mund të marrin pjesë edhe persona të caktuar nga njësiat përkatëse e vetëqeverisjes vendore. Pas inspektimit, grupi i inspektimit, i propozon drejtuesit të strukturës vendore të Policisë, masat administrative që duhen marrë.

7. Në përfundim të inspektimit, konkluzionet i njoftohen edhe subjektit të inspektuar, si dhe bazuar në aktin e inspektimit, lihen për zbatim detyra, brenda afateve të caktuara, me qëllim që masat shtesë të sigurisë të jenë funksionale dhe efektive, si dhe përcaktohet data e rikontrollit të detyrave të lëna.

8. Në përfundim të inspektimeve të kryera, sipas planit të inspektimit, nga struktura vendore e policisë hartohet një raport i plotë, ku përshkruhen veprimet e kryera, konstatimet, detyrat e lëna, si dhe masat administrative të marra. Raporti i dërgohet drejtorisë përkatëse në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

9. Ngarkohet Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Fatmir Xhafaj



UDHËZIM

Nr. 11, datë 10.4.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 52, DATË 3.12.2015 “PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË
GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE
NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET
NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 76 dhe të pikës 3 të nenit 78 të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Tabela nr. 1, bashkëlidhur udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, 2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1/1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

Tabela 1/1

Në mbështetje të Kuadrit të Referencave për Gjuhët të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët Europian të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, njeh testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
<i>Gjuha angleze</i>			
Cambridge	PET	FCE	CAE
IELTS	4.0 / 5.0	5.5 / 6.0	6.5 / 7.0
TOEFL Internet-based Test (iBT)	57/86	87/109	110/120
TOEFL Paper-based Test (ITP)	460	543	627
TOEIC	381 / 649	650 / 785	786 / 935
GESE	-	7, 8, 9	10, 11
APTIS	Aptis B1	Aptis B2	Aptis C
<i>Gjuha gjermane</i>			
Goethe-Institut, Goethe Zentrum TestDaF	Goethe-Zertifikat B1	Goethe-Zertifikat B2	Goethe-Zertifikat C1
	-	TDN 3 - TDN4	TDN 5
<i>Gjuha franceze</i>			
TFI	345/604	605/824	825
DELF	DELF B1	DELF B2	DALFC1
TCF	TCF 300 - 399	TCF 400 - 499	TCF 500 - 599
TEF	TEF 361-540	TEF 541-698	TEF 699-833
<i>Gjuha italiane</i>			
Peruggia	CELI2 livello2	CELI3 livello3	CELI4 livello4
Sienna	CILS uno B1	CILS 2	CILS 3
<i>Gjuha spanjolle</i>			
DELE	DELE inicial	DELE intermedio	DELE superior



VENDIM
Nr. 35, datë 18.4.2017
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.01.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 83/19 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Subi Cami, Skënder Meta, Nezir Kola, Besim Qinami, Ramiz Mena, Zyra Përmbarrimore Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Subi Cami, Skënder Meta, Nezir Kola, Besim Qinami dhe Ramiz Mena, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Zyres Përmbarrimore Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 13002, datë 04.12.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Administrator i saj rezulton z. Mentor Spahiu.

2. Në bazë të vërtetimit të pronësisë nr.5154, datë 05.07.1996 kërkuësja është bërë pronare e një trualli me sipërfaqe 1555 m², një pjesë të të cilit e zë godina, kurse pjesa tjetër 924 m² figuron truall i lirë. Në këtë truall janë vendosur në mënyrë të paligjshme subjektet e interesuara Subi Cami, Skënder Meta, Nezir Kola, Besim Qinami dhe Ramiz Mena. Për këtë arsye kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kthimin e sendit dhe lirimin e truallit.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.77, datë 17.01.1997, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.2733, datë 14.11.1997. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.794, datë 21.04.1998 ka vendosur prishjen e dy vendimeve të lartpërmendura dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, por me tjetër trup gjykues.

4. Gjykata e Apelit Tiranë në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 28, datë 12.05.1999, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke detyruar subjektet e interesuara Subi Cami, Skënder Meta, Nezir Kola, Besim Qinami dhe Ramiz Mena të lirojnë sipërfaqet e truallit të përcaktuara në aktin e ekspertimit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 371 akti, datë 13.07.1999, ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e vendimit nr. 28, datë 12.05.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.651, datë 19.03.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara të lartpërmendura.

7. Kërkuësja i është drejtuar Zyres Përmbarrimore Tiranë në datën 10.02.2002 për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 28, datë 12.05.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

8. Zyra Përmbarrimore ka filluar veprimet për ekzekutimin e vendimit në vitin 2002, por ato janë pezulluar më vonë për shkak të rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara. Shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. i është drejtuar Zyres Përmbarrimore në datën 08.06.2004, duke kërkuar vënien përsëri në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, pasi Gjykata e Lartë kishte vendosur mospranimin e rekursit.

9. Zyra Përmbarrimore, me shkresën nr.976/Gj, datë 22.06.2004, ka urdhëruar ekzekutimin



vullnetar të vendimit të formës së prerë, ndërsa me shkresën nr.976/F, të datës 25.10.2004 ka lajmëruar palët, Komisariatin e Policisë nr.2 dhe Policinë Ndërtimore Tiranë se ekzekutimi i detyrueshëm do të kryhej në datën 04.11.2004, ora 900-1000.

10. Sipas procesverbalit nr.976/F të datës 04.11.2004, pala kreditore nuk është paraqitur në atë datë për ekzekutimin e vendimit. Përfaqësuesi i kërkuësës është paraqitur në Zyrën Përmbartimore në datën 26.11.2004, duke shpjeguar se nuk mund të paraqitej për shkaqe shëndetësore. Zyra Përmbartimore po në atë rrethanë i ka shpjeguar se për ekzekutimin e vendimit duhen mjetet e duhura dhe fuqia punëtore, që kjo e fundit i nuk disponon dhe pa të cilat nuk mund të kryhet asnjë veprim.

11. Me shkresën nr.976/Gj, nr.689 prot., datë 02.02.2005, Zyra Përmbartimore i ka drejtuar shoqërisë “Kulturë Sport Impex” sh.a. të njëjtën kërkesë lidhur me sigurimin e mjeteve dhe fuqisë punëtore, si dhe i ka komunikuar të paraqitej në datën 10.02.2005. Nga procesverbali i datës 10.02.2005 rezulton se shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. nuk është paraqitur edhe pse ka pasur dijeni të lajmërimit.

12. Në datën 10.02.2005 shoqëria Kulturë Sport Impex sha ka bërë ankim administrativ ndaj veprimeve përmbartimore, duke parashtruar se nuk ka mundësi të gjejë mjete dhe fuqinë punëtore për ekzekutimin e vendimit.

13. Me vendimin nr. 022/976/F, datë 11.03.2005 Zyra Përmbartimore Tiranë ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit.

14. Me kërkesën nr.1726 prot., datë 18.03.2005 shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. i ka kërkuar Zyrës Përmbartimore faturën e shpenzimeve, ndërsa me kërkesën nr.226/1, datë 07.11.2005 ka kërkuar nxjerrjen nga arshiva të dosjes dhe vënien në ekzekutim të saj.

15. Në vitin 2006 kanë filluar përsëri procedurat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë (shkresa nr.596/F, nr.1656 prot, datë 17.02.2003, lajmërim për ekzekutim vullnetar). Nga shkresa nr.596/F, nr.6390 prot., datë 26.06.2006 rezulton se debitorët Nezir Kola, Sybi Cami, dhe Skënder Meta janë paraqitur pranë Zyrës Përmbartimore, ndërsa shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. nuk është paraqitur për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm.

16. Zyra Përmbartimore, me shkresën nr.596/F, nr.8470 prot., datë 21.09.2006, ka urdhëruar ekzekutimin vullnetar të vendimit të formës së prerë, duke lajmëruar palët, si dhe Komisariatin e Policisë nr.6, Njësinë Bashkiake nr.6 dhe Policinë Ndërtimore Tiranë, këto të fundit që t'i mbështetnin me forcat e tyre, se ekzekutimi i detyrueshëm do të kryhej në datën 04.10.2006, ora 1000-1100.

17. Sipas procesverbalit të datës 04.10.2006, pala kreditore nuk është paraqitur për ekzekutimin e vendimit dhe në këtë datë nuk janë kryer veprime procedurale.

18. Me shkresën nr.596/F, nr.11600 prot., datë 18.12.2006 është vendosur pezullimi i veprimeve përmbartimore.

19. Në datën 08.11.2007 shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. ka bërë përsëri kërkesë për vënien në ekzekutim të vendimit të formës së prerë. Në vitin 2008 kanë filluar përsëri procedurat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë (shkresa nr.95 regjistri, nr.4788 prot, datë 21.04.2008, lajmërim për ekzekutim vullnetar). Ndërsa me shkresën nr.38 regjistri, nr.9669 prot., datë 26.06.2009 është vendosur pezullimi i veprimeve të ekzekutimit me kërkesë të kreditorit.

20. Në vitin 2016 sipas kërkesës për vënien në ekzekutim të vendimit të formës së prerë të shoqërisë “Kulturë Sport Impex” sh.a., kanë rifilluar procedurat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Me shkresën nr.6363 prot, datë 04.07.2016 është bërë kërkesë për mbështetje në ekzekutim, duke lajmëruar palët, si dhe Komisariatin e Policisë nr.6, Njësinë Bashkiake nr.6 dhe INUV-në pranë Bashkisë Tiranë, këto të fundit që t'i mbështetnin me forcat e tyre, se ekzekutimi i detyrueshëm do të kryhet në datë 26.07.2016, ora 10:00 e në vijim. Për shkak të mosparaqitjes së forcave të policisë, Zyra Përmbartimore ka rënë dakord me shoqërinë “Kulturë Sport Impex” sh.a. që ekzekutimi të shtyhej në datën 17.10.2016, ora 10:00. Edhe në këtë datë nuk janë paraqitur forcat e policisë dhe ekzekutimi është shtyrë për në datën 22.11.2016, ora 10:00. Data tjetër e radhës për ekzekutim, gjithmonë për mosparaqitje të forcave të policisë, ka qenë më 23.12.2016, ora 10:00.

21. Gjatë veprimeve si më sipër, shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. i është drejtuar me shkresë shumë institucioneve, të tilla si Policisë Ndërtimore, Ministrisë së Drejtësisë,



Kryeministrit, Drejtorisë Qendrore të Përmbartimit, për zbatimin dhe ekzekutimin e rregullt të vendimit gjyqësor.

II

22. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Ajo parashtroi se nuk është vepruar për të vënë në ekzekutim menjëherë vendimin gjyqësor dhe se institucionet kanë zvarritur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, duke mos qenë të predispozuar për t'i zbatuar ato.

23. **Subjektet e interesuara**, *Subi Cami, Skënder Meta, Nezir Kola, Besim Qinami dhe Ramiz Mena*, kanë prapësuar se ata nuk janë bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, pasi kanë qenë gjithmonë të pranishëm gjatë veprimeve procedurale të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

24. **Subjekti i interesuar**, *Zyra Përmbartimore Tiranë*, ka parashtuar me shkrim të gjitha veprimet përmbartimore që ka kryer (si më lart të detajuara), duke theksuar se do të vijojë procedurat për ekzekutimin e titullit ekzekutiv konform neneve 523, 524 e në vijim të KPC-së dhe 27 e 30 të ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbartimor gjyqësor” për të bërë të mundur lirimin e sendit objekt ekzekutimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

25. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka

vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe të autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të çështjes duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimin nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret konstatohet se nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë (13.07.1999), deri në paraqitjen e kërkesës para kësaj Gjykate (27.09.2016) ka kaluar një periudhë më shumë se 17-vjeçare. Një periudhë e tillë për ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë konsiderohet nga Gjykata si një afat i paarsyeshëm dhe i tejzgjatur, ndaj vlerësimi i secilit prej elementeve të lartpërmendura ka rëndësi për çështjen në shqyrtim.

i. Kompleksiteti i çështjes

28. Kërkesa në shqyrtim ka për objekt ekzekutimin e një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur për sipërfaqet e truallit, të përcaktuara sipas aktit të ekspertimit, që çdo subjekt i interesuar duhet të lirojë. Për pasojë, Gjykata çmon se çështja nuk paraqet kompleksitet ligjor të veçantë. Në këto kushte, Gjykata thekson se vlerësimi i sjelljes së



kërkueses dhe i autoriteteve publike është me rëndësi në këtë kontekst.

ii. Sjellja e kërkuesit

29. Kohëzgjatja për të ekzekutuar vendimet gjyqësore të formës së prerë është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para tejkallimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet edhe me veprimet ose mosveprimet e kërkuesit, të cilat mund të kenë çuar në mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e caktuara nga ligji.

30. Në çështjen konkrete, nga materialet e dosjes, rezulton se kërkuesja i është drejtuar Zyrës Përmbartimore në vitin 2002, pra rreth 2 vjet e gjysmë pas marrjes së urdhrit të ekzekutimit. Pas disa veprimeve të para të Zyrës Përmbartimore (shkresa nr.317/F, datë 15.03.2002 - urdhërimi për lirimin e truallit drejtuar subjekteve të interesuara; shkresa nr.317, datë 10.04.2002 - urdhërimi i tyre të qëndrojnë në banesë për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë), ajo ka vendosur pezullimin e ekzekutimit për shkak të rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara. Shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. i është drejtuar Zyrës Përmbartimore në datën 08.06.2004 duke kërkuar vënien përsëri në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, pasi Gjykata e Lartë kishte vendosur mospranimin e rekursit.

31. Zyra Përmbartimore, me shkresën nr.976/Gj, datë 22.06.2004, ka urdhëruar ekzekutimin vullnetar të vendimit të formës së prerë, ndërsa me shkresë nr.976/F të datës 25.10.2004 ka lajmëruar palët, Komisaratin e Policisë nr.2 dhe Policinë Ndërtimore Tiranë se ekzekutimi i detyrueshëm do të kryhej në datën 04.11.2004, ora 900-1000. Sipas procesverbalit nr.976/F të datës 04.11.2004, shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. nuk është paraqitur në atë datë për ekzekutimin e vendimit. Përfaqësuesi i kërkueses është paraqitur në Zyrën Përmbartimore në datën 26.11.2004 duke shpjeguar se nuk mund të paraqitej, për arsye shëndetësore. Zyra Përmbartimore në atë rast, por edhe me shkresën nr.976/Gj, nr.689 prot., datë 02.02.2005, i ka kërkuar shoqërisë “Kulturë Sport Impex” sh.a. sigurimin e mjeteve të duhura dhe të fuqisë punëtore për ekzekutimin e vendimit, pa të cilat nuk mund të kryhet asnjë veprim.

32. Gjykata vëren se kanë vijuar disa shkresa (*shih paragrafët nr.11-19*) ndërmjet palëve, nga të cilat rezulton se në datat e përcaktuara për ekzekutimin

e vendimit të formës së prerë shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a. nuk është paraqitur, arsye për të cilën Zyra Përmbartimore ka vendosur disa herë pezullimin e vendimeve për ekzekutimin e vendimit në vitet 2005, 2006 dhe 2009. Gjithashtu, Gjykata konstaton se pas çdo vendimi pezullimi shoqëria kreditore ka kërkuar vënien përsëri në ekzekutim të vendimit të formës së prerë. Pas pezullimit të ekzekutimit në vitin 2009, me vullnet të shoqërisë kreditore, kjo e fundit ka riparaqitur kërkesë për vijimin e procedurave në vitin 2016, pra pas rreth 7 vjetësh. Gjykata vlerëson se për këtë periudhë vetë kërkuesi me veprimet e tij, është bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Ndërsa me fillimin e veprimeve procedurale të ekzekutimit në vitin 2016, kërkuesja ka qenë gjithmonë e pranishme.

33. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pavarësisht kërkesave dhe ankimeve administrative të bëra nga shoqëria “Kulturë Sport Impex” sh.a., edhe neglizhenca e saj ka ndikuar në tejzgjatjen dhe mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

iii. Sjellja e autoriteteve

34. Për të përcaktuar sjelljen e autoriteteve në këtë çështje, Gjykata vlerëson se është e nevojshme të vlerësohet nëse Zyra Përmbartimore, si i vetmi organ kompetent për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ka marrë masat e nevojshme për ta ekzekutuar atë, pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata.

35. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr.13, datë 21.03.2012; nr.43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata në jurisprudencën e saj, gjithashtu, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Po në këtë drejtim autoritetet shtetërore nuk mund të



justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimin nr.1, datë 21.01.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, sikurse u përmend më lart, Gjykata çmon se edhe pse përmbaruesi, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, nuk i ka shfrytëzuar ato. Përmbaruesi gjyqësor është kufizuar në lajmërimet për ekzekutim vullnetar dhe atë të detyruar, dhe duke qenë se forcat policore nuk kanë qenë të pranishme gjatë ekzekutimit të detyruar, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve të duhura, ai nuk ka vazhduar më tej me veprimet e tij. Zyra Përmbarimore nuk rezultoi se i ka kryer të gjitha procedurat e nevojshme, me qëllim vënien në ekzekutim të vendimit të formës së prerë, si vendosjen e gjobës për mosekzekutim të vendimit gjyqësor apo marrjen e masave të tjera ndaj forcave të rendit, që disa herë janë bërë pengesë në ekzekutimin e vendimit.

38. Në këtë drejtim Gjykata konstaton se neni 523 i KPC-së parashikon detyrimin për bashkëpunim, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor dhe në rast nevoje, të Policisë së Rendit apo të inspektoratit ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe të Inspektoratit Kombëtar. Këto organe janë të detyruara të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit. Po kështu neni 30 i ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarimor gjyqësor” thotë: “Përmbaruesi gjyqësor, për kryerjen e detyrave të ngarkuara, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me Policinë Ndërtimore dhe policitë e tjera, me organet e pushtetit vendor dhe prefekturat. Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesin gjyqësor në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë që kërkohet ndihma e tyre. Policia e Shtetit dhe ajo Ndërtimore vë në dispozicion të përmbaruesit gjyqësor mjete dhe forca të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të tij, sipas ligjit”*. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se mungesa e mjeteve dhe fuqisë punëtore të përmendura në disa shkresa të Zyrës Përmbarimore apo edhe kostot financiare, janë thjesht një problem faktik, të cilat nuk duhet të përbëjnë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor.

39. Nga sa më lart, Gjykata gjen me vend të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes dhe të bashkëpunimit të këtyre organeve për të siguruar shmangien e situatave të tilla, të cilat mund të bëhen pengesë në ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.

40. Bazuar në këto rrethana, Gjykata rithekson qëndrimin e saj se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri autoritetet kanë detyrimin për të siguruar mundësitë e duhura për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë dhe jo të paraqesin arsye për ta penguar atë. Për pasojë, në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se edhe pse sjellja e kërkuarit është bërë në disa raste shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, ka qenë edhe sjellja e përmbaruesit gjyqësor që ka ndikuar në zvarritjen e këtij procesi tej çdo afati të arsyeshëm.

41. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.28, datë 12.05.1999 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Vladimir Kristo

**VENDIM****Nr. 46, datë 31.3.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “C.G.C”
SH.P.K. NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 105, 107; nenit 22 pika 2 germa “ç”; nenit 83 pika 1 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; neneve 4, pika 1, germa “ç”; neni 8 dhe 9 pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 10, pika 1 nenin 11 të “Rregullave dhe Procedurave për Licencimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesshëm ose të Plotë, Heqjen ose Rinovimin e Licencave në sektorin e Gazit Natyror” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.9, datë 11.2.2011, nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.6.2016 Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C.G.C” SH.P.K, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror të shoqërisë “C.G.C” sh.p.k.

Konstatoi se:

- Formatit dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, germa “d”/i, d/ii, është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Gjerat: d/iv, d/v, d/vi(identitetin e personave qe kanë interes pronësor më të madh dhe të barabartë se 5%, dokumentet që tregojnë titujt e pronësisë, lejet dhe autorizimet mjedisore), janë të paplotësuara;

- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, germa e/i, e/ii, e/v, e/vi(vërtetim nga drejtoria e tatimeve, bilancet financiare, pagesa e aplikimit në ERE, plani i biznesit), janë plotësuar;

- Germa: e/viii(garanci e preformancës) nuk ka informacion.

- Dokumentacioni specifik për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa e/i, e/ii, sasia e gazit në Nm³ dhe garancia e cilësisë gazit), është e pa plotësuar

- Dokumentet specifike për llojin e licencës (neni 9 pika 2 germa e/iii garancia financiare), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mangësitë e konstatuara referuar: neni 9, pika 1, germa d/iv, d/v, d/vi; neni 9, pika 1 germa e/viii; neni 9, pika 2, germa e/i, e/ii, do të njoftohet subjekti në bazë të nenit 10 pika 1 të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”,

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “C.G.C” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM**Nr. 47, datë 31.3.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GRID ENERGY” SH.P.K, NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe në zbatim të neneve 4, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 19, pika 1, germa “a” të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017,



mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr.40, datë 6.3.2017, vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për Licencim të shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) - vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 48, datë 31.3.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GRID ENERGY” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe 39 pika 3, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 4, pika 1, germa “d”; neni 5, pika 1, germa “d”, neni 13; të Rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19 pika 1 të “Rregullores së organizimit funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 39, datë 6.3.2017, vendosi: “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë “Grid Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7.1, geramat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Grid Energy” sh.p.k, në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 49, datë 31.3.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS SË
LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGJI
UNIVERS” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 4 pika 1 germa “e”; 5 pika 1 germa “e” dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k, dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr.20, datë 31.1.2017, vendosi mosfillimin e procedurës për licencimin e

shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për mangësi në dokumentacionin e aplikimit.

- Në vijim të sa më sipër shoqëria “Energji Univers” sh.p.k. ka hapur në QKB çështjen me nr. CN-161093-02-17, datë 17.2.2017, e cila ka lidhje me depozitimin e vendimit të asamblesë datë 09.02.2017, duke përfshirë në objekt të veprimtarisë së saj, tregtimin e energjisë elektrike.

- Shoqëria “Energji Univers” sh.p.k., ka paraqitur në ERE me shkresën nr. 119/4, datë 28.2.2017, formatin e aplikimit, ekstratin e QKB, si dhe një deklaratë e cila shpreh se vendos në dispozicion të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike shumën 25.000 euro në llogarinë e saj bankare në Raiffeissen Bank.

- Aplikimi i shoqërisë “Energji Univers” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike si më poshtë:

- Formatin e aplikimit (neni 9, pika 1 geramat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 geramat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 geramat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.8 geramat “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENERGJI UNIVERS” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 50, datë 31.3.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 germa “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19 pika 1 germa “a” e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.3.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alb Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1 germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “ALB ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 52, datë 6.4.2017**

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT
NR. 190 DATË 22.12.2016, TË BORDIT TË
ERE-S, DERI NË 31.12.2017**

Në mbështetje të neneve 10 pika 2, 16, 20 germa “c”, neni 83, 85 dhe 109 pika 5 të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” nenit 22 të Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, si dhe rekomandimet e MEI-t për shtyrjen e afatit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. nr. 191, datë 22.12.2016 ka vendosur mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017;

- Bordi i ERE-s me vendimin 192, datë 22.12.2016, ka vendosur mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifave për çdo nivel tensioni për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017;



- Bordi i ERE-s, me iniciativën e vet, me vendimin nr. 31 datë 20.2.2017 është shprehur për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, KESH sh.a. për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

- Bordi i ERE-s me iniciativën e vet, me vendimin nr. 32 datë 20.2.2017, është shprehur për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

Në zbatim të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” përgjatë procesit të shqyrtimit të këtyre aplikimeve janë kryer veprimet e mëposhtme procedurale.

- Publikimi i aplikimit në faqen zyrtare të ERE-s brenda afatit që përcakton rregullorja duke i kërkuar zyrtarisht edhe shoqërisë OSHEE sh.a. dhe OST sh.a. të zbatojnë detyrimin për të bërë publikimin nga ana e tyre të aplikimeve respektive.

- Njoftimi i palëve të interesuara me shkresën nr. 265 prot. datë 30.3.2017 për zhvillim seance dëgjimore në lidhje me rishikimin e tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017 në kuadër të aplikimit përkatës të OSHEE.

- Analiza e informacioneve të marra në lidhje me të ardhurat e kërkuara nga ana e shoqërive.

- Analiza ka konsistuar në krahasimin e të ardhurave të kërkuara, të miratuara nga bordi i ERE-s për vitin 2015 dhe atyre faktike për të njëjtën periudhë, shpenzimet faktike të viti 2016 si dhe ato të pritshme për vitin 2017 sipas aplikimeve dhe informacioneve shtesë.

- Nga këto analiza dhe vlerësime të përgjithshme rezulton se, shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë performancë të kënaqshme e përgjithësisht kanë mbuluar kostot e veprimtarive të këtyre aktiviteteve përgjatë periudhës 2015-2016 si dhe kanë krijuar një rezervë për zhvillimin normal të aktiviteteve të licencuara dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës në operim.

- Shkresa e MEI me nr. 682/2, datë 3.4.2017, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim edhe të parashikimeve të

nenit 10 pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” vlerëson mbajtjen e të njëjtit regjim tarifor për vitin 2017 për të tre kompanitë për arsytet:

- *Ministria e Energjisë dhe Industrisë është drejt përfundimit të procesit për bërjen efektive të Marrëveshjes së Huas mes KESH sh.a. dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin “Shqipëria, Plani i Ristrukturimit të KESH”, Marrëveshja e Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të garantojë përmirësimin e kushteve financiare të parashikuara, me qëllim që të shmanget kostot financiare shtesë.*

- *Nga ana e MEI –t gjithashtu në bashkëpunim me Bankën Botërore, po përmbyllet procesi i rishikimit të Planit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike dhe problematika e marrëdhënieve të ndërsjella të kompanive, masa të cilat do të pasqyrojnë më qartë situatën e përmirësuar financiare të sektorit dhe do të reflektonin në mënyrë transparente rezultatet e reformave të kryera në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat e cituara më sipër. Nevoja për investime mbetet akoma një imperative për sistemin në përgjithësi dhe atë të shpërndarjes në veçanti. Ndërkaq, prej një viti sistemi nuk merr më mbështetje nga buxheti i shtetit por kontribuon në të duke shlyer të gjitha detyrimet. Rishikimi i planit synon të përmirësojë treguesit target dhe të rrisë në një nivel cilësor më të lartë performancën.*

- *Në përfundim, mbajtja e sistemit tarifor do mbështesë sektorin energjetik nëpërmjet qëndrueshmërisë financiare.*

- Me vendimin 194 datë 30.12.2016 bordi I ERE ka vendosur në pikën 2: Deri në miratimin e tarifës së Transmetimit të energjisë elektrike për të cilën kanë filluar procedurat me vendimin e Bordit të ERE-s nr.191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a. të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016 të Bordit të ERE.

- ERE, për gjithë sa më sipër, gjykon të mos përcaktojë tarifa të reja për vitin 2017, përfshirë edhe tarifën për shërbimin e transmetimit procedura për shqyrtimin e së cilës ka filluar me vendimin e Bordit të ERE nr. 191, datë 22.12.2016.



- Me përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për periudhën e mbetur të vitit 2017, mbyllen procedurat e nisura me vendimet nr. 191 dhe nr. 192 datë 22.12.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohshme të energjisë elektrike të miratuara me vendimet nr. 139, nr. 145, nr. 146, nr. 147, dhe nr. 148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

2. Fuqia juridike e vendimit nr. 13, datë 16.2.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016”, sipas pikës 1 të vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE, shteron me marrjen e vendimit për përcaktimin e tarifës fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017 në zbatim të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

3. Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a të vijoje të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me vendimin nr. 78, datë 7.6.2016 të Bordit të ERE deri në afatin e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Autoritetin e Konkurrencës si dhe të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 53, datë 6.4.2017

MBI ÇMIMIN E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI UNIVERSAL PËR KATEGORINË OBJEKTE KULTI/BASHKËSI FETARE

Në mbështetje të neneve 16; 85 pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Rekomandimit të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, përcjellë në ERE me anë të shkresës nr. 3791, datë 16.12.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.4.2017, pasi shqyrtoi, relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- Njëpërmjet shkresës nr. 390, prot datë 29.09.2016, Komiteti Shtetëror për Kultet ka parashtruar kërkesën mbi mundësinë e ndryshimit të tarifës së energjisë elektrike për bashkësitë fetare.

- Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen e Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese njëpërmjet shkresës nr. 3791 prot, datë 16.12.2016.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 22.12.2016, vendosi: “Fillimin e procedurave për rishikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Universal për kategorinë Klient - Objekte Kult/Bashkësi Fetare”.

- Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, me anë të shkresës nr. 8/17, datë 23.2.2017, parashtroi një relacion për të pasqyruar një kuadër të përgjithshëm të veprimtarive të strukturave të Kishës Katolike.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Klientët - objekte kult/bashkësi fetare të klasifikuar të tillë sipas legjislacionit në fuqi, të faturohen me çmimin 9.5 lekë për kWh nga data 1 prill 2017 deri në 31.12.2017.

2. Drejtorja e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a., Ministrinë e



Energjisë dhe Industrisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Komitetin Shtetëror për Kultet për vendimarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 2273, datë 19.4.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (loti 3)” për pasuritë e llojit “pyll”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së

masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “pyll”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 740 500 (shtatëqind e dyzet mijë e pesëqind) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që preken nga zbatimi i projektit "Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (Loti 3)"

Nr.	Pronari			Z.K.	NR.PAS	Lloji i Pasurisë	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Bashkëpronarët		Haxhijaj	2330	53/1	pyll	15000	7405	100	740500	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA TOTALE										740500	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 140 lekë